



UNIVERSITETI I MITROVICËS  
UNIVERSITY OF MITROVICA  
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +383-28535725/535727

Kryesues i Senatit  
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 487  
Dt 27.03.2020

### UMIB fillon me mësimin on-line

Të dashur studentë, staf akademik, administrativ, familjarë dhe publik i nderuar,

Në bazë të përgjegjësive të dhëna nga Statuti i përkohshëm i UMIB-it, ju njoftoj se, procesi mësimor në UMIB, në të gjitha njësitë akademike dhe në të gjitha nivelet, është duke u zhvilluar dhe do të vazhdoj në formatin on-line, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Mësimi on-line zhvillohet në platformat:

- <http://smu.umib.net>
- <https://meet.google.com/>
- <https://classroom.google.com/>

Dekanët dhe Zyra e TI-së do të ndërmarrin të gjitha masat që stafi akademik dhe studentët të organizojnë ligjëratat dhe ushtrimet on-line.

Stafi akademik dhe studentët mund të ndjekin **Udhëzuesit për përdorimin e platformave për mësim on-line** të përgatitur nga Zyra e TI-së, të publikuar në web-faqen e UMIB-it. Zyra e TI-së është në ndihmë të stafit akademik për organizimin e mësimin on-line.

Sekretari përgjithshëm dhe administrata do ta përshtatin punën e tyre në përkatësi të mësimin on-line.

Të dashur studentë dhe profesorë,

Vendimi për mësimin on-line vjen si rrjedhojë e pandemisë Covid 19 dhe vendimit të qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërprerjen e procesit mësimor në territorin e Kosovës.

Vendimi është marrë pas një sërë konsultimesh me udhëheqjen e UMIB-it, me prorektorët, dekanët, stafin akademik, studentët dhe administratën, si dhe në konsultim me MASHTI-n dhe në marrëveshje me Konferencën e Rektorëve të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe, janë bërë disa prova të mësimin on-line dhe rezultatet janë shumë optimiste. Edhe stafi akademik, edhe studentët kanë treguar gatishmëri të plotë në këtë proces.

Ne besojmë se, mësimi on-line është rruga më e mirë për vazhdimin e procesit mësimor në UMIB, e që do ta rrisin nivelin e përdorimit të teknologjisë informative në procesin e arsimit të lartë në Kosovë, por njëkohësisht i kontribuon ruajtjes së shëndetit të studentëve e të profesorëve, gjatë periudhës së izolimit nëpër shtëpitë tona për shkak të pandemisë.

Shëndet dhe suksese!



Rektor i UMIB-it

Prof. Dr. Alush Musaj